



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dispozitat e nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391 të dt. 25.2.2010, dhe propozimit të Grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016, të dt. 07.06.2016, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 08.06.2016, miratoi

PLANIN **VJETOR TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS**

I.

MIRATOHET Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2016.

II.

Plani vjetor i cekur në pikën I të këtij vendimi, përmban: numrin e mbledhjeve, muajin në të cilin do të mbahet mbledhja e Kuvendit të Komunës dhe pikat - temat orientuese që do të shqyrtohen nga ana e Kuvendit të Komunës.

III.

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës me përmbajtjen e cekur në pikën II të këtij vendimi, është si në vijim:

1. Mbledhja I, muaji janar:

- Informatë e Kryetarit të Komunës për Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2016;
- Raporti i Kryetarit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës për periudhën Korrik - Dhjetor 2015;
- Informatë për Raportin për vlerësimin e performancës së Komunës (nga Drejtoria për Administratë);

Akivitetet

- Debati publik me qytetarë

2. Mbledhja II, muaji shkurt:

- Propozimvendimi për rikategorizimin e parkut regional natyror " Gërmia", në kategorinë peizazh i mbrojtur " Gërmia";

- Propozimrregullorja për organizimin e punës në shkolla fillore, të mesme të ulta dhe të mesme të larta;
- Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren mbi taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifrat për rregullimin e infrastrukturës;
- Propozimvendimi për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të bashkësive lokale;
- Përopozimvendimi për formimin e grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për bashkësi lokale;
- Shqyrtimi i raportit buxhetor për situatën ekonomiko - financiare të Komunës për periudhën korrik – dhjetor 2015;
- Barta e buxhetit nga viti 2015 në vitin 2016;

Aktivitetet

- Mbledhje solemne me rastin e ditës së shpalljes së pavarësisë së Kosovës

3. Mbledhja III, muaji mars:

- Shqyrtimi i Raportit final financiar të Komunës për vitin 2015;
- Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim pa pagesë të një pjese të SHML “ Gjinnazi matematikorë”, për institutin ndërkombëtar për intelegjencë të jashtëzakonshme “Atomi”;
- Propozimvendimi për këmbimin e pronave të komunës me prona private;
- Shqyrtimi i raporteve të komisioneve komunale të aksionarëve të NPL - ve për vitin 2015;

4. Mbledhja IV, muaji prill:

- Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016;
- Propozimplani lokal i veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar;
- Miratimi për diskutim publik të propozimplaneve rregulluese;
- Shqyrtimi dhe miratimi i planeve rregulluese të hollësishme;
- Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën janar – mars 2016;
- Informatë për mbjelljet pranverore.

5. Mbledhja V, muaji maj:

- Propozimrregullorja për taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifrat për rregullimin e infrastrukturës për vitin 2016;
- Propozimvendimi për lënien në diskutim publik të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave;
- Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
- Propozimvendimi për këmbimin e pronave të paluajtshme të komunës me pronat e personave fizik dhe juridik;
- Shqyrtimi i propozimplanit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016;

6. Mbledhja VI, muaji qershor:

- Rishikimi i buxhetit për vitin 2016;
- Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore për periudhën 2017 – 2019;
- Informatë për menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve në Komunë;
- Diskutimi për arsimin në Komunën e Prishtinës;
- Informatë për përgatitjen e korrje-shirjeve për kulturat bujqësore – drithërat e bardha.

Aktivitetet

- Dëgjimet publike rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore 2017 – 2019;
- Mbledhje solemne me rastin e ditës së çlirimit të Prishtinës.

7. Mbledhja VII, muaji korrik:

- Raporti i Kryetarit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës në periudhën Janar – Qershor 2016;
- Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën prill – qershor 2016;
- Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën për vitin 2015;
- Informatë për realizimin e Planit Vjetor të Prokurimit Publik 2015;
- Informatë për Raportin për vlerësimin e performancës së Komunës (nga Drejtoria e Administratës);
- Themelimi i Grupit punues për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2017;
- Raporti për përfundimin e objektit të bibliotekës “ Hivzi Sylejmani” dhe destinimi i objektit të vjetër.

Aktivitetet

- Debati publik me qytetarë

8. Muaji gusht:

Pushim

Aktivitetet

- Organizimi i dëgjimeve publike rreth buxhetit të Komunës për vitin 2017

9. Mbledhja VIII, muaji shtator:

- Shqyrtimi i projektbuxhetit të Komunës për vitin 2017;
- Shqyrtimi i Projektregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2017;
- Shqyrtimi i projektregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjopa komunale për vitin 2017;
- Informatë për suksesin e nxënësve, përfundimin e vitit shkollor 2015/2016 dhe fillimin e vitit shkollor 2016/2017;
- Informatë për përfundimin e procesit të korrje-shirjeve;
- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2017.

Aktivitetet

- Organizimi i dëgjimeve publike rreth buxhetit të Komunës për vitin 2017.

10. Mbledhja IX, muaji tetor:

- Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën korrik - shtator 2016;
- Informatë për procesin e trajtimit të ndërtimeve ilegale;
- Informatë për ndarjen e bursave për studentë;
- Informatë rreth mbjelljeve vjeshtore.

11. Mbledhja X, muaji nëntor:

- Informatë për fillimin e ngrohjes për sezonin dimëror;
- Informate për ndarjen e subvencioneve në bujqësi;
- Informatë për gjendjen në shëndetësi.

12. Mbledhja XI, muaji dhjetor:

- Propozimvendimi për ndryshimin e Rregullores për parkun regional natyror "Gërmia";
- Propozimvendimi për lënien në diskutim publik të Rregullores për transportin e udhëtarëve;
- Propozimvendimi për lënien në diskutim publik të Rregullores për transportin e udhëtarëve me auto - taksì;
- Informatë për Planin Vjetor të Prokurimit Publik 2017;
- Informatë për Planin Vjetor të Auditorit të Brendshëm 2017.

IV.

Për zbatimin e pikës III të këtij vendimi do të kujdesen: Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, drejtorët e drejtorive, drejtorët e institucioneve shëndetësore dhe arsimore dhe komisioni komunal i aksionarëve për ndërmarrjet publike lokale.

V.

Ky plan hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së administratës të pushtetit lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web- faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 052-143778 ,më 10.06.2016

KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.



Arsyetim

Kuvendi i Komunës funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë vetëqeverisjen lokale, dhe në bazë të Statutit të Komunës së Prishtinës.

Sipas LVL - së, Kuvendi i Komunës nuk e delegon përgjegjësinë e tij lidhur me marrjen e Vendimit për planin vjetor të punës së tij (neni 40, paragrafi 40.1, pika d).

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 18.05.2016, ka themeluar Grupin punues për hartimin e propozimplanit të Kuvendit të Komunës për vitin 2016.

Grupi punues ka mbajtur takim më 07.06.2016 dhe pas finalizimit të këtij propozimplani, ai i është dërguar për shqyrtim Kuvendit të Komunës.